3. Treguesit mjedisor të ujit

Zhvillimi industrial, urbanizimi, bujqësia intensive janë vetëm disa prej faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ujërave. Përkundër angazhimit të vazhdueshëm, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve tona ujore.

Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizikë, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujorë. Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse me ç 'rast vije deri tek rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike (fertilizerët-N, P, K, NH_4^+ etj.) dhe atyre organike (PCB, Herbicide etj). Ndër presionet më të mëdha në trupat ujorë janë edhe shkarkimet industriale të veprimtarive të ndryshme.

3.1. Nutrientët në ujëra sipërfaqësore

Emri i treguesit	**Nutrientët në ujërat sipërfaqësor**
Kodi i treguesit	U01
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i gjendjes
Përshkrimi i treguesit	Me këtë tregues paraqitet koncentrimi i ortofosfateve dhe nitrateve në lumenj, fosfori i përgjithshëm dhe i nitratit në liqene dhe nitrateve në ujërat nëntokësorë që të mundësohet depërtimi në shkallën e eutrofikimit e cila shkakton shtimin e shpejtë të algave dhe bimëve të larta dhe formimin e ndryshimeve të padëshirueshme të balancimit të ekosistemit si dhe vetë kualitetit të ujit.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Ky tregues përcaktohet në bazë të të dhënave vjetore të monitorimit duke llogaritur vlerën mesatare vjetore për secilën vend matje ashtu që fitohen nivele të rregullta, dhe përcaktojmë mesataren për vlerën e koncentrimit të nitrateve (NO_3), fosforit të përgjithshëm dhe ortofosfatit ($PO4^-$ P).
Njësia matëse	Koncentrimi shprehet në miligram për litër (mg/l).
Burimi i të dhënave	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Nutrinetët janë një tregues i rëndësishëm i cilësisë së ujit sipërfaqësor sepse azoti inorganik dhe fosfori kontrollojnë rritjen e bimëve ujore. Azoti inorganik, i cili është i tretshëm në ujë, arrin në ujërat sipërfaqësorë gjatë procesit të rrjedhjes së ujërave nga tokat bujqësore të trajtuara me pleh, ose indirekt përmes ujërave nëntokësore. Edhe Fosfori, po ashtu përdoret në formën e plehun që i hidhet tokave bujqësore dhe arrin në ujërat sipërfaqësorë si rezultat i erozionit. Këta nutrientë arrijnë në ujërat sipërfaqësorë gjithashtu edhe nga shkarkimet e ujërave të kanalizimeve apo nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

Në figurën 1 është prezantuar trendi i koncentrimit të Azotit të Nitrateve (mg/l) në ujërat sipërfaqësore (lumenj) për periudhën kohore 2008-2019. Nga figura vërehet se koncentrimi i Azotit të Nitrateve gjatë kësaj periudhe kohore është ndërmjet 0.658 mg/l, si vlera më e ulët e regjistruar në vitin 2009, dhe 1.181 mg/l si vlera më e lartë e regjistruar në vitin 2018. Viti 2019, shënon një ngritje të koncentrimit (1.100 mg/l), krahasuar me vitin paraprak 2018 (0.814 mg/l). Në përgjithësi trendi i këtij treguesi për periudhën kohore 2008-2019, na paraqitet si linear me disa ndryshime të vogla me tendencë rritjeje për vitet 2008, 2013 dhe 2019.



Figura 1: Azoti i Nitrateve (mg/l) në ujërat sipërfaqësore (2008-2019)[1]

Në figurën 2 është prezantuar trendi i koncentrimit të Fosforit të Ortofosfateve (mg/l) në ujërat sipërfaqësore (lumenj) për periudhën kohore 2008-2019. Nga figura vërehet se koncentrimi i Fosforit të Ortofosfateve gjatë kësaj periudhe kohore është ndërmjet 0.118 mg/l, si vlera më e ulët e regjistruar në vitin 2013, dhe 0.265 mg/l si vlera më e lartë e regjistruar në vitin 2019. Viti 2019, shënon një ngritje të koncentrimit, krahasuar me vitin paraprak 2018 (0.126 mg/l). Në përgjithësi trendi i këtij treguesi për periudhën kohore 2008-2019, na paraqitet me oscilime (ulje dhe ngritje) dhe nuk ka një rrjedhë lineare.

[1] *Burimi i të dhënave: Monitorimi u ujërave sipërfaqësore (lumenjëve) nga IHMK 2008-2019*



Figura 2: Fosfori i Ortofosfateve (mg/l) në ujërat sipërfaqësore (2008-2019)[2]

3.2. Shpenzimi biokimik i oksigjenit

Emri i treguesit	**Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit**
Kodi i treguesit	U02
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i gjendjes
Përshkrimi i treguesit	Me këtë tregues paraqitet shpenzimi i oksigjenit në lumenj që tregon gjendjen dhe trendin në aspektin e koncentrimit të materieve organike (ndotja) në formë të harxhimit biologjik të oksigjenit dhe koncentrimit të përgjithshëm të amoniakut ku koncentrimi i jonit të amoniumit ($NH4^+$) tregon mundësinë e aktivitetit të baktereve të mbeturinave të cilat përmes sistemit të kanalizimit ose larjeve arrijnë në sipërfaqen e ujit.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Ky tregues vendoset në bazë të të dhënave të monitorimit vjetor të llogaritura me vlerën mesatare vjetore për secilin vend-matje ashtu që të fitohen nivele të rregullta dhe cakton mesataren (mediana) për vlerat e shpenzimit biologjik të oksigjenit, shpenzimit kimik të oksigjenit dhe koncentrimit të jonit amonium ($NH4^+$).
Njësia matëse	Shpenzimi biologjik dhe kimik i oksigjenit shprehet në mg/l, ndërsa koncentrimi i jonit amonium shprehet me mg/l.
Burimi i të dhënave	Institucioni përgjegjës për monitorimin e gjendjes së ujërave sipërfaqësore (Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës)
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

[2] *Burimi i të dhënave: Monitorimi u ujërave sipërfaqësore (lumenjëve) nga IHMK 2008-2019*

Shpërbërja biologjike e materieve organike nga mikro gjallesat kërkon oksigjen nga uji. Nisur nga kjo treguesi SHBO5 është vlerësim i materies biologjikisht të shpërbëshme në ujë. Bakteret e përdorin materialin organik në ujë si burim ushqimi. Gjatë këtij procesi materiali organik oksidohet deri në produkte të qëndrueshme dhe përfundimtare si CO_2 dhe H_2O. Sasia e O_2 të nevojshëm në këtë proces quhet shpenzim biokimik i oksigjenit dhe konsiderohet si masë e përbërësve organikë si ndotës.

Trendi i koncentrimit për treguesin Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit SHBO5 (mg^-/l) në ujërat sipërfaqësore (lumenj) për periudhën kohore 2008-2019 është prezantuar në figurën 3. Nga të dhënat e prezantuara vërehet se koncentrimi i SHBO5 gjatë kësaj periudhe kohore ka pasur pothuajse një rritje progresive përgjatë viteve 2008-2017, me një rënie të ndjeshme në dy vitet e fundit. Vlerat e koncentrimit mesatar të regjistruara kanë qenë ndërmjet 3.934 mg/l, si vlera më e ulët e regjistruar në vitin 2011, dhe 17.590 mg/l si vlera më e lartë e regjistruar në vitin 2017. Viti 2019 (14.740 mg/l), shënon një ngritje të koncentrimit, krahasuar me vitin paraprak 2018 (12.425 mg/l).



Figura 3: Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit $SHBO_5$ (mg/l) në ujërat sipërfaqësore 2008-2019

3.3. Indeksi i kualitetit të ujërave sipërfaqësor

Emri i treguesit	**Indeksi i kualitetit të ujërave sipërfaqësor**
Kodi i treguesit	U03
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i gjendjes
Përshkrimi i treguesit	Ky tregues bazohet në metodën e llogaritur të indeksit të kualitetit të ujit sipas së cilës dhjetë parametrat fiziko-kimik dhe kualiteti mikrobiologjik grumbullohen në përmbledhjen e treguesve të ujërave sipërfaqësor.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Metoda e indeksit të kualitetit të ujit (WQI - Water Quality Index) të dhjetë parametrave të zgjedhur (*ngopshmëria me oksigjen, $SHBO_5$, joni amonium, vlera e pH, azoti i përgjithshëm, ortofosfati, materiet e suspenduara, temperatura, përçueshmëria elektrike dhe bakteret koliforme*) me kualitetin e tij (q_i) përfaqëson vetitë e ujit sipërfaqësor duke e reduktuar në një numër indeksi. Pjesa e secilit nga dhjetë parametrat në kualitetin e përgjithshëm të ujit nuk kanë domethënie relative të njëjtë, ashtu që secili prej tyre fiton indeksin e tij të peshës (w_i) dhe numri i pikëve sipas ndarjes dhe rrezikimit të kualitetit. Me mbledhjen e prodhimit (q_i x w_i) fitohet indeksi 100 si mbledhje ideale e ndarjes së kualitetit të të gjithë parametrave. Në rastin kur mungon e dhëna e kualitetit për ndonjë parametër atëherë vlera e matjes aritmetike WQI korrigjohet me shumëzimin e indeksit me vlerën 1/x, ku x është shuma aritmetike e indeksit të matur të peshës së parametrave të disponueshëm.
Njësia matëse	Treguesit shprehen si më poshtë, në bazë të llogaritjes së kualitetit të ujit WQI: • WQI=0-38 kualitet shumë i keq; • WQI=39-71 kualitet i keq; • WQI=72-83 kualitet i mirë; • WQI=84-89 kualiteti shumë i mirë; • WQI=90-100 kualitet i shkëlqyeshëm.
Burimi i të dhënave	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, të dhënat nga monitorimi vjetor i ujërave sipërfaqësor.
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Treguesi Indeksi i kualitetit të ujërave sipërfaqësor, nuk është zhvilluar në mungesë të të dhënave zyrtare për monitorimin biologjik të ujërave sipërfaqësore, që aktualisht nuk realizohet në kuadër të monitorimit të rregullte nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, apo ndonjë institucion tjetër relevant.

3.4. Kualiteti i ujit për pijes

Emri i treguesit	Kualiteti i ujit për pijes
Kodi i treguesit	U04
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i gjendjes
Përshkrimi i treguesit	Me këtë tregues paraqitet kualiteti i ujit të pijshëm nga sistemi i furnizimit me ujë nëpërmjet përcjelljes së mostrave të ujit të pijshëm të cilat nuk kënaqin kriteret e përshkruara të kualitetit.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Ky tregues përcaktohet në bazë të numrit të mostrave të parregullta dhe numrit të përgjithshëm të mostrave ku testohen treguesit fiziko-kimik dhe mikrobiologjik. Treguesit paraqiten së bashku ose veçmas për grupe harxhuese të caktuar.
Njësia matëse	Përqindja (%) e mostrave jo të rregullta (jo të përshtatshme) në nivel vjetor.
Burimi i të dhënave	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Ky tregues është i rëndësishëm sepse cilësia e ujit të pijes është e ndërlidhur drejtpërdrejtë me shëndetin publik. Cilësia e ujit të pijes që ofrohet nga kompanitë publike të ujësjellësve ka shënuar rritje përgjatë periudhës 2008-2018. Përderisa në vitin 2008, 94.9% të mostrave të analizuara për cilësi fiziko-kimike dhe mikrobiologjike kanë qenë të përshtatshme sipas standardeve të ujit të pijes, në vitin 2017, kjo përshtatshmëri ka arritur në 99.8%, me një progres prej 3.9%. Viti 2018 ka shënuar një rënie të ndjeshme të përshtatshmërisë sipas standardeve të ujit të pijes, me një rënie prej 0.4%, krahasuar me vitin paraprak (figura 4).



Figura 4: Trendi i cilësisë së ujit të pijes 2008-2018[3]

[3] *Burimi i informacionit: ARRU, Raportet e performaces 2008-2018*

3.5. Përdorimi i resurseve të ujërave të ëmbla

Emri i treguesit	**Përdorimi i resurseve të ujërave të ëmbla**
Kodi i treguesit	U05
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i presionit
Përshkrimi i treguesit	Me këtë tregues paraqitet sasia e përgjithshme e ujit e nxjerrë nga burimet e ujërave të ëmbla, ku përdoret për përdorimin e furnizuesit me ujë, në bujqësi, në prodhim industrial dhe për përdorimin e ftohjes në industrinë e energjisë si dhe marrjen e sasisë së ujit për përdorim nga secili sektor i përmendur.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Përdorimi i përgjithshëm i ujërave të ëmbla llogarit në bazë të të dhënave të sasisë së ujit të nxjerrë për përdorimin e furnizimit me ujë, në bujqësi, në industrinë përpunuese dhe energjetike. Trendi i sasisë së përgjithshme të ujit të nxjerrë dhe trendi sipas sektorëve shprehet gjatë viteve për të dhënat që janë të disponueshme.
Njësia matëse	Sasia e përgjithshme e ujit të nxjerrë dhe sasia e ujit të nxjerrë sipas sektorëve shprehin në milion metër kub për vit (10^6 m^3/vit).
Burimi i të dhënave	Agjencia e Statistikave të Kosovës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit. Kompanitë Regjionale të Ujërave
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Një prej formave të ndikimit të drejtpërdrejtë në mjedis është edhe shfrytëzimi i resurseve ujore. Të dhënat flasin se pjesa më e madhe e ujërave përdoren nga ujësjellësit publik për furnizim me ujë të pijes, për amvisëri dhe për nevojat e konsumatorëve tjerë të kompanive publike të ujësjellësve. Bujqësia është sektori i dytë zhvillimorë i përdorimit të ujit, kryesisht për ujitjen e tokave bujqësore. Në sektorin e energjisë uji përdoret për ftohje ndërsa në industri për prodhim dhe ftohjen e pajisjeve. Trendi i përgjithshëm i përdorimit të ujit është në rritje dhe sasia vjetore e shfrytëzimit sillet ndërmjet 200-270 milion m^3 ujë në vit (figura 5).



Figura 5: Sasia e ujit të shpenzuar milion m³/vit sipas sektorëve 2009-2019[4]

3.6. Humbjet e ujit

Emri i treguesit	**Humbjet e ujit**
Kodi i treguesit	U06
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i reagimit
Përshkrimi i treguesit	Me këtë tregues paraqitet humbja e ujit e cila shfaqet/gjenerohet nga rrjedhja ose avullimi gjatë distribuimit/shpërndarjes në mes të nxjerrjes së ujit dhe vendit të dorëzimit që të tregohet për efikasitetin e rregullimit me furnizim të ujit.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Humbjet e ujit vlerësohen në bazë të diferencës absolute dhe relative në mes sasisë së nxjerrë të ujit dhe sasisë së dërguar për konsumatorë.
Njësia matëse	Humbjet e ujit shprehen në milion metër kub për vit (10^6 m³/vit), të paraqitura në përqindje (%) të sasisë së ujit të nxjerrë.
Burimi i të dhënave	Agjencia e Statistikave të Kosovës-ASK, Autoriteti Rregullator për Ujësjellës dhe Kanalizime-ARRUK
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

[4] Të dhënat për shfrytëzimin e ujit nga ujësjellësit publik janë marrë nga Raportet e performancës së ARRUK, të dhënat për ujitje nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, kurse të dhënat për shfrytëzimin e ujit në Energji dhe Industri nga Raportet vjetore te operatorëve: KEK, SharCem dhe NewCoFeronikel.

Në bazë të vlerësimeve nga Autoriteti Rregullator i Ujësjellësve dhe kanalizimeve, humbjet e ujit në vitin 2019 ishin rreth 90 milion m^3 ujë. Krahasuar me vitin paraprak humbjet shënojnë një rënie të ndjeshme, ndërsa krahasuar me vitin 2012 shënojnë rritje për rreth 9 milion m^3 ujë (figura 6).



Figura 6: Humbjet e ujit (m^3/vit) 2008-2019

3.7. Qasja në ujësjellësit publik

Emri i treguesit	**Qasja në ujësjellësit publik**
Kodi i treguesit	U07
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i reagimit
Përshkrimi i treguesit	Me këtë tregues paraqitet përqindja e popullsisë me qasje në sistemin e ujësjellësit publik.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Ky tregues paraqet përfshirjen e numrit të përgjithshëm të popullsisë me qasjen në sistemin e ujësjellësit.
Njësia matëse	Treguesi paraqitet në përqindje (%).
Burimi i të dhënave	Autoriteti Rregullator për Ujësjellës dhe Kanalizime, Agjencia e Statistikave të Kosovës.
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Sipas raporteve të përformancës së Kompanive të Ujësjellësit dhe Kanalizimit, në zonën e shërbimit të këtyre kompanive mbulushmëria me shërbimin e ujësjellësit në vitin 2018 ishte 97%, që shënon një rritje prej 3% më shumë se sa në vitin paraprak dhe për 29% krahasuar me vitin 2002 (figura 7).

Në rritjen e qasjes në shërbimin e ujësjellësit publik kanë ndikuar investimet që janë realizuar në këtë sektor nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donatorët e ndryshëm. Në vitin 2019, ARRU ka ndryshuar metodologjinë e kalkulimit të këtij treguesi duke përfshirë në vlerësim edhe sistemet e reja te ujësjellësit në zonat rurale dhe popullsinë e atyre zonave, prandaj ka një ndryshim në % e mbulushmërisë me shërbimin e ujësjellësit në zonën e shërbimit të KRU.



Figura 7: Mbulushmeria me shërbimin e ujësjellësit (%), 2002-2019[5]

3.8. Qasja në kanalizimet publike

Emri i treguesit	**Qasja në kanalizimet publike**
Kodi i treguesit	U08
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i reagimit
Përshkrimi i treguesit	Me këtë tregues paraqitet përqindja e popullsisë me qasje në sistemin e kanalizimit publik.
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Ky tregues paraqet përfshirjen e numrit të përgjithshëm të popullsisë me qasjen në sistemin e kanalizimit.
Njësia matëse	Treguesi paraqitet në përqindje (%).
Burimi i të dhënave	Autoriteti Rregullator për Ujësjellës dhe Kanalizime, Agjencia e Statistikave të Kosovës
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

[5] *Burimi i informacionit: ARRU, Raportet e performances 2002-2018*

Sipas raportit të performancës së Kompanive të Ujësjellësit dhe Kanalizimit, në zonën e shërbimit të këtyre kompanive mbulushmëria me shërbimet e ujërave të ndotura (kanalizim) në vitin 2018 ishte 77% që shënon një rritje prej 3% më shumë se në vitin paraprak dhe 34% më shumë se sa në vitin 2002, (figura 8). Në rritjen e qasjes në shërbimin e kanalizimit publik kanë ndikuar investimet që janë realizuar në këtë sektor nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donatorët e ndryshëm. Në vitin 2019, ARRU ka ndryshuar metodologjinë e kalkulimit të këtij treguesi duke përfshirë në vlerësim edhe sistemet e reja nga zonat rurale dhe popullsinë e atyre zonave, prandaj ka një ndryshim në % e mbulushmërisë me shërbimin e ujërave të ndotura në zonën e shërbimit të KRU.



Figura 8: Mbulushmeria me shërbimin e kanalizimit (%) 2002-2019[6]

3.9. Qasja në impiantet për trajtimin e ujërave të zeza

Emri i treguesit	**Qasja në impiantet për trajtimin e ujërave të zeza**
Kodi i treguesit	U09
Lloji i treguesit sipas modelit DPSIR	Tregues i reagimit
Përshkrimi i treguesit	Me këtë tregues paraqitet përqindja e banorëve të cilët kanë qasje në impiantet për trajtimin e ujërave të zeza me trajtim primar, sekondar dhe/ose terciar, në raport me numrin e përgjithshëm të banorëve, atij kumulativ dhe sipas shkallës së trajtimit të ujërave të zeza (ku janë përfshirë vendbanimet me numrin ekuivalent të popullsisë (p.e) më të madh së 2000).
Metodologjia e përcaktimit të treguesit	Ky tregues përcaktohet me llogaritjen e pjesës së popullsisë me qasjen në impiantet për trajtim të ujërave të zeza krahas numrit të përgjithshëm të numrit të banorëve, ashtu që numri i banorëve me qasje në sistemin e kanalizimit publik, me qasje në impiant për trajtim të ujërave të zeza, pjesëtohet me numrin e përgjithshëm të

[6] *Burimi i informacionit: ARRU, Raportet e performaces 2002-2018*

	banorëve dhe shumëzohet me 100. Ky tregues po ashtu mund të llogaritet për secilën shkallë veç e veç të trajtimit të ujërave të zeza (primare, sekondare dhe terciare).
Njësia matëse	Treguesi shprehet në përqindje (%).
Burimi i të dhënave	Autoriteti Rregullator për Ujësjellës dhe Kanalizime, Agjencia e Statistikave të Kosovës
Dinamika kohore e mbledhjes së të dhënave	Në baza vjetore.

Ende nuk është zhvilluar ky indikatorë meqenëse Kosova ndodhet në fazën e ndërtimit të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.
Është në fazën e ndërtimit impianti për trajtimin e ujërave të zeza për regjionin e Prizrenit, ndërsa që janë kryer studime të fisibilitetit për trajtimin e ujërave edhe për regjionin e Gjakovës, Pejës, Gjilanit, Prishtinës, Ferizajt dhe Mitrovicës. Studimi i fisibilitetit dhe projektit për Prizren, Gjakovë dhe Pejë është financuar nga KFW (Banka Gjermane për Zhvillim) dhe Qeveria e Kosovës, ndërsa, studimi i fisibilitetit për trajtimin e ujërave urbane për Gjilanin, Ferizaj dhe Mitrovicë është financuar nga Bashkimi Evropian.
Aktualisht impiante funksionale për trajtimin e ujërave të ndotura janë impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në Skenderaj me kapacitet vjetor rreth 734,421 m^3, i menaxhuar nga KRU "Mitrovica", si dhe 2 impiante për trajtimin e ujërave të ndotura (Harilaq dhe Badovc) me kapacitet të vogël (104,750 m^3/vit) dhe të menaxhuar nga KRU "Prishtina". Shprehur në përqindjen e numrit total të banorëve të cilët kanë qasje në impiantet për trajtimin e ujërave të zeza me trajtim këto kapacitete janë të papërfillshme dhe prezantojnë më pak se 1% të popullatës.